



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

Sheshi "Bil Clinton" Nr. 13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Clinton" Br. 13 Prishtina, Kosovo
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenc.org

Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009 për Ndërmarrjet Publike, nenin 21 paragrafi 4 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare 06/L-016; Ligjin e Punës Nr. 03/L-212; Statutin Nr. 08/868 të datës 30.05.2022 të NH "Ibër Lepenc" Sh.A, si dhe Kodin e Qeverisjes Koorporative për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e mbajtur në 29.03.2026, miraton:



**RREGULLOREN NR.05/2026 PËR NDËRTIMIN E URAVE TË REJA MBI
KANALET E NDËRMARJES HIDRO EKONOMIKE IBËR LEPENC SH.A**

PRISHTINË, MARS 2026

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e kushteve teknike, për ndërtimin e urave, mbi kanalet e Ndermarjes Hidroekonomike IL, ku do të definohen standardet e sigurisë dhe qëndrueshmërisë, si dhe procedurat e aprovimit dhe kontrollit, duke trajtuar edhe çështjete pronësore dhe juridike në kuadër të saj. Implementimi i këtyre projekteve ka si qëllim të përmirësojë qarkullimin e këmbësorëve dhe veturave, me qëllim të rritjes së sigurisë së lëvizjes.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Të gjitha kushtet të cilat kërkohen për standardet dhe procedurat e adresimit për trajtimin e të drejtave dhe përgjegjësive pronësore, lidhur me ndërtimin e urave metalike, me qëllim shërbimi për komunitetin e jo për individët e caktuar, janë në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë. Dispozitave të kesaj rregulloreje duhet t'u përmbahen: Punonjësit e Ndërmarrjes Hidroekonomike N.H Ibër Lepenc (zyrtarët përgjegjës), zyrtarët përgjegjës të komunave përkatëse të cilët janë kompetent dhe kanë interes për implementimin e të njejtës, byrotë projektuese të cilat hartojnë projektin, në bazë të krkesave teknike të parapara me aneksin e kesaj rregulloreje.

2. Të gjitha kushtet të cilat kërkohen për standardet dhe procedurat e adresimit për trajtimin e të drejtave dhe përgjegjësive pronësore, lidhur me ndërtimin e urave metalike, me qëllim shërbimi për komunitetin e jo për individët e caktuar, janë në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë.

Neni 3

Vendodhja dhe Prioritetet

Vendndodhja e objekteve do të bazohet në kërkesat e komuniteteve të komunave përkatëse dhe vlerësimin tekniko-financiar që do të trajtohet nga stafi i inxhinierëve të të njejtave (Komuna). Lista e prioriteteve duhet të përfshijë zonat përgjatë kanalit kryesor të Ibër Lepenc. Investimi ka si qëllim sigurimin e lëvizjes së banorëve dhe automjeteve, ndërhyrjen në kohë për minimizimin e dëmeve, rritjen e sigurisë rrugore dhe lidhjen me rrugët kryesore.

KAPITULLI II PROCEDURAT STANDARDE PËR PROJEKTIM DHE MIRATIM

Neni 4 Procedurat Standarde

1. **Kërkesa e palës** - për ndërtimin e lëshesës pllakore ose urës mbi kanalin e ujitjes së Ndërmarrjes Hidroekonomike Iber-Lepenc, kërkesa duhet të bëhet tek organet komunale gjegjëse me të cilat Ndërmarrja IL ka memorandum mirëkuptimi. Në kërkesë duhet të paraqiten edhe dëshmi / fotografi dhe lista e qytetarëve me nënshkrime.
2. **Identifikimi i Lokacionit** – pas pranimit të kërkesës nga organet komunale Kryeshefi Ekzekutiv (IL) formon një komision të brendshëm profesional. Komisioni të përbëhet nga 5 anëtarë kompetent të fushës, i cili vihet direkt në kontakt me zyrtarët kompetent komunal. Ky komision brenda afatit prej 15 ditëve kryen identifikimin në terren dhe konform profilin, të kanalit të ujitjes, të jap pëlqim/refuzim për lokacionin e përshtatshëm konform rregullores së brendshme, duke njoftuar KE dhe organet komunale përkatëse, Në rast se lokacioni i perzgjedhur nga organet komunale paraqet problem në funksionimin e infrastrukturës së Ndërmarrjes Hidroekonomike IL, kërkesa refuzohet dhe kthehet në ri/shqyrtim tek parashtruesit (komuna).
3. **Përmbajtja e projektit** – Punët paraprake për fillimin e hartimit të projektit të urës/lëshesës:
 - a. Skanimi gjeodezik i lokacionit realizohet nga gjeodet i licencuar. Skanimi përfshinë matjet në një gjatësi prej 400 m nga lokacioni i përcaktuar në dy drejtimet e (djathtas 200m+majtas 200m). Përveç kanalit të Ndërmarrjes IL duhen të paraqiten rrugët ekzistuese, pengesat (mure, rrethoja, parapete betoni, objekte etj.), lëshesat pllakore të punuara ekzistuese, parcelat e vektorizuara etj. Elaborati gjeodezik duhet të dorëzohet në formë të shtypur, ta ketë tabelën e përmbajtjes, legjendën, vulën e biznesit / gjeodetit dhe deklaratën e përgjegjësisë të nënshkruar dhe vulosur. Elaborati dorëzohet në formë digjitale *.pdf dhe *.dwg (të vektorizuar në sistemin Kosova ref.)
 - b. Hulumtimet gjeomekanike për zonën e interesit ku së paku dy shpime nën taban të themeleve të lëshesës/urës (nga një për secilin themel) dhe dy të tjera plotësuese për të vlerësuar stabilitetin e skarpatës në afërsi të kanalit. Shpimet duhet të kryhen nga personel dhe laborator të certifikuar në nga Institucionet relevante të akredituara. Duhet të punohet profili litologjik gjatësor ndërmjete sondimeve dhe të ipen rekomandimet për thellësinë e fondimit, shtresat e tamponit dhe në bazë të hulumtimeve të përcaktohet kategoria dhe nxitimi i truallit sipas EC8. Thellësia e sondimit dhe distanca mes sondimit përcaktohet sipas EC7 pjesa e dytë. Po ashtu, gjeologu që realizon hulumtimin duhet të nënshkruaj një deklaratë të përgjegjësisë mbi hulumtimin e prezantuar.

KAPITULLI III PËRMBAJTJA E PROJEKTIT

Neni 5

Projekti i lëshesës pllakore


1. Projekti i urës-lëshesës pllakore duhet të përmajë: dispozitën e themeleve me dimensione të dukshme dhe piketim në sistem koordinativ Kosova Ref.
2. Prerjen gjatësore me kuota të fondimit dhe shtresat e tamponit, mbushjes, hidroizolimi, shtresat e asfaltit, elementet e mbi strukturës dhe nënstrukturës. Në rast të dimensioneve të mëdha >12m duhet te paraqitet edhe sistemi i drenazhimit te ujerave atmosferik sipërfaqësore.
3. Prerjen tërthore me kota të fondimit dhe dhe shtresat e tamponit, mushjes, hidroizolimi, shtresat e asfaltit, elementet e mbi strukturës dhe nënstrukturës. Në rast të dimensioneve te medha >12m duhet te paraqitet edhe sistemi i drenazhimit te ujerave atmosferik sipërfaqësore.
4. Detajet e armimit, llojin e çelikut, diametrin dhe specifikacionin e armaturës sipas EN 1992-1-1 dhe EN 10080. Detajet e konstruksionit të çelikut sipas dhe klasat e përdorura sipas EC3 apo EN 10025. Poashtu të behet projekti i recepturës së betonit, (të përcaktohen klasat e ekspozimit të ambientit, adetivet, granulometria) nga autoritet i licencuar dhe certifikuar për prodhim të betonit.
5. Dispozitën e ngarkesave sipas EN 1991-2: Eurocode 1 – Veprimet në struktura – Pjesa 2: Ngarkesat e trafikut në ura rrugore dhe hekurudhore.
6. Analizën e strukturës - modelin matematikor në formë të raportit të shtypur të nënshkruar dhe vulosur.
7. Përshkrimin teknik te strukturës dhe te materialeve të shtypura të nënshkruara dhe vulosur nga bartësi i projektit.
8. Metodologjinë e punës – të përshkruhen: Analiza dhe planifikimi, Marrja e lejeve, Përgatitja e kantierit, Zbatimi i punimeve, Kontrolli dhe sigurimi i cilësisë, Dorëzimi i objektit, Mirëmbajtja pas ndërtimit.
9. Plani dinamik i punëve i shtypur, vulosur dhe i nënshkruar.
10. Masat e sigurisë për mbrojtjen e gropës ndërtimore dhe ruajtjen e stabilitetit të kanalit sidomos tek kanalet ku rrjedha e ujit funksionon 24h/7 të vitit.
11. Zgjidhjen teknike të qarkullimit/projektin e rrugëve së paku në gjatësi 100m në të dy anët e kanalit, planin e situacionit, profilat gjatësore dhe profilat tërthore të rrugës.
12. Paramasa dhe parallogaria me cmime të tregut të nënshkruara dhe vulosura.
13. Deklaratën e nënshkruar nga inxhinieri (konstruktiv) mbi përgjegjësinë dhe autorësinë e projektit. *Te gjitha materjalet e lartcekura duhen të jenë në formë të shtypur; të vulosur dhe të nënshkruar. Poashtu duhet të dorëzohen në format digjital *.dwg, *.pdf, *.xmls, *.doc*

KAPITULLI IV KOMISIONI I NDËRMARRJES HIDROEKONOMIKE IL

Neni 6

Fusha e përgjegjesive procedurale të komisionit të Ndërmarrjes

1. Pas pranimit dhe analizave të projektit komisioni i brendshëm i IL të caktuar me vendim të KE brenda 10 ditë (ditë pune) duhet të lëshojë një deklaratë/pëlqim për ndërtimin e strukturës në fjalë, e cila më pas dërgohet tek KE për miratim.
2. Në deklaratë duhet të ceken periudhat kalendarike, në të cilat mund të fillojnë punimet e strukturës dhe ato duhet të përfundohen para fillimit të sezonit të ujitjes. Në rast se projekti në fjalë nuk është në përputhje me rregulloret teknike të brendshme të Ndërmarrjes IL ky komision i paraqet vërejtjet apo kërkesat plotësuese me shkrim mbi projektin dhe e dërgon tek organet relevante komunale për plotësim.



KAPITULLI V PRANIMI TEKNIK

Neni 7

Procedurat e inspektimit dhe pranimit teknik

1. Gjatë implementimit të projektit (ndërtimit), Ndërmarrja Hidroekonomike IL, përmes vendimit të Kryeshefit Ekzekutiv, gëzon të drejtën e emërimit të një zyrtari kompetent, të fushës, që ta dërgojë si mbikqyrës për inspektimin e mbarëvajtjes së procesit të punimeve, konform rregullave teknike të kësaj rregulloreje.
2. Zyrtari sipas piks 7.1.1 të kësaj rregulloreje, vendosë kontakt me menaxherin e projektit nga komuna përkatëse dhe e njofton lidhur me ndonjë shqetësim eventual, gjatë implementimit të projektit në fjalë dhe i njejtë kërkon nga zyrtari përgjegjës komunal që ta zbatojë projektin konform pëlqimit të lëshuar nga Ndërmarrja Hidroekonomike IL. Në rast se vërejtjet e paraqitura nuk përfillen punimet, pezullohen apo edhe nderpriten tërësisht duke tërhequr pëlqimin.
3. Pas pëfundimit të ndërtimit të veprës, me rastin e themelimit të komisionit për pranim teknik të komunave gjegjëse me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv caktohet një anëtar nga Ndërmarrja Hidroekonomike IL, si anëtar i barabartë në pranimin teknik të projektit. Poashtu paraprimit teknik duhet të behet testimi dhe kapaciteti i strukture nga laborator i certifikuar nga DAK.

KAPITULLI VI PRONËSIA DHE MIRËMBAJTJA

Neni 8

Pronësia dhe procedurat e mirëmbajtjes

1. Ndërmarrja Hidroekonomike IL, si pronare legjitime e pronës/parcelave përkatëse, në rast të zhvillimit të projekteve përkatëse, për qëllimë zhvillimore të Ndërmarrjes, ka të drejtën e rrënit, të kësaj strukture (urës). Poashtu kur vie në interes mbrojtja e aseteve të Ndërmarrjes, apo në rast të ndonje vis major (fuqi madhore), proceduralisht me një njoftim paraprak, ndërmirren veprimet e njejtë ndërvepruese.
2. Në momentin e pranimit teknik, ura si strukturë dhe përgjegjësia për mirëmbajtje dhe sanim, i takon inventitorit, përkatësisht (komunës përkatëse).

KAPITULLI VII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 9

Aneksi i kësaj rregulloreje

Pjesë e kësaj rregulloreje është aneksi teknik i bashkangjitur.

Neni 10

Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore mbi hyn në fuqi në Prill dhe shfuqizon çdo akt apo rregullore të më hershme të aplikuar lidhur me urat mbi kanalën kryesor.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Drejtorëve.




Bajram MUSTAFA

Kryesues i Bordit të Drejtorëve

NPH "Ibër Lepenc" SH.A

ANEKSI I RREGULLORES

Neni 1

RREGULLAT TEKNIKE MINIMALE PER LESHESAT PLLAKORE-URAT MBIKALIM

Qëllimi i këtij dokumenti shërben për interesa të ndermarrjes IL në mënyre që të standardizohen dhe të tipizohen strukturat mbikalim mbi asetet/kanalet ekzistuese. Në varësi të lokacionit, pozitës, nivelit të rrugës që kalon përsiper kanalit do të japim disa rekomandime teknike minimale të huazuara nga rregulloret dhe standardet për struktura në vendin tone:

Neni 2

Kushtet gjeometrike

1. Dimensionet minimale të pjesës qarkulluese për trafik të urës/leshësës duhet të jenë ≥ 5.50 m, ku duhet të përfshihet edhe shtegu për këmbësorë (minimalisht në njërin anë) me gjerësi minimale prej 1.00 m. Në rastet kur rruga e projektuar që kalon mbi kanalën e ndërmarrjes IL ka projekt të detajuar dhe është e kategorizuar, atëherë gjerësia e urës duhet të përshtatet me profilin karakteristik të asaj rruge, por në asnjë rast nuk duhet të jeteë më e vogël se $\geq (1.00 + 5.50 + 1.00)$. Në çdo situatë, për shkak të kërkesave të mirëmbajtjes, duhet të sigurohet lartësia e profilit të lirë nga fundi i kanalit deri te elementet e mbistrukturës, e cila nuk duhet të jeteë më e vogël se ≥ 1.80 m. Për problematikat e pa parapara në këtë tekst projektuesi të nenshtrohet rregullave "Standardet e rrugëve për punët ndërtimore për rrugë & ura Kosova e administruar nga KB: 2004".




Fig.1 Prerja tërthore e urës automobilistike $\geq 1+5.50+1m'$

2. Në rastet kur kërkesa për ndërtimin e strukturës i referohet një numri të vogël banorësh dhe parashikohet kalim vetëm për mjete motorike me peshë deri në 3.5 t, dimensionet minimale të pjesës qarkulluese për trafik të urës/leshës duhet të jenë ≥ 4.50 m. Në këto raste, struktura mund të projektohet:

- a) si sistem ramë prej betoni të armuar (BA), ose
- b) me bregore prej betoni dhe mbistrukturë prej çeliku me soletë kompozite.

Projektimi dhe dimensionimi i elementeve duhet të bëhet në përputhje me standardet përkatëse, përfshirë Eurocode 2 për betonin dhe Eurocode 3 për çelikin dhe Eurocode 4 për struktura kompozite. Per problematikat e pa parapara ne kete tekst projektuesi ti nenshtrohet rregullave “Standardet e rrugëve për punët ndërtimore për rrugë & ura Kosova e administruar nga KB: 2004”.




Fig.2 Prerja tërthore e urës automobilistike (ram nga BA) ≥ 4.50 m'




Fig.3 Prerja tërthore e urës automobilistike (mbistrukturë metalike) ≥ 4.50 m'

3. Thellessia e fundimit të themeleve – për shkak të mureve të holla të kanaleve trapezoidale ekzistuese ($t=6\sim 8$ cm) të Ndërmarjes IL ndikimet e themeleve në truall mund të paraqesin ndikime indirekte shtesë të cilat mund të kontribuojnë në qarje apo deformime të kanalit. Për këtë arsye thellessia e fundimit teknikisht duhet të nivelizohet me kuotën e fundit të kanalit. Verejtje në rast se kërkesat gjeoteknike për fundim të strukturës kërkojnë fundim më të thellë se kuota fundore e kanalit atëherë kjo e fundit merret në konsideratë. Dimensionet minimale duhet të caktohen sipas skicave dhe “Standardet e rrugëve për punët ndërtimore për rrugë & ura Kosova e administruar nga KB: 2004”.




Fig.4 Prerja gjatësore e urës automobilistike (ram nga BA dhe mbistrukturë kompozite me celik)

4. Krahët e urës, varësisht nga pozita e tyre, mund të projektohen si krahë paralel, nën kënd ose në kënd të drejtë (90°). Gjatësia minimale e krahëve nuk duhet të jetë më e vogël se **5.00 m**. Në varësi të pozicionit të krahëve, duhet të parashihen edhe parmakë metalikë si masë shtesë për sigurinë e këmbësorëve. Në rastet e kanaleve me thellësi të ulët, ku nuk mund të arrihet lartësia e lirë për mirëmbajtje prej **1.80 m**, niveleta e urës duhet të ngritet. Në këto raste, krahët e urës detyrimisht projektohen në kënd të drejtë (90°), ndërsa gjatësia dhe lartësia e tyre përshtaten me mbushjen e rrugëve anësore, duke parandaluar shembjen e materjalit në kanalën e ndërmarrjes HE IL. Nëse gjatësia e krahëve kalon **10.00 m**, atëherë ata duhet të projektohen ndaras me fuga dilatuese nga shtylla bregore, duke funksionuar si mure mbrojtëse të veçanta. Për nevoja plotësuese projektuesi të konsultohet me “Standardet e rrugëve për punët ndërtimore për rrugë & ura Kosova e administruar nga KB: 2004”.




Fig.5 Dukja nga sipër e urës (ram nga BA) $\geq 5.50m'$




Fig.6 Dukja nga sipër e urës (ram nga BA) $\geq 4.50m'$

6. Pllaka e tranzicionit duhet të punohet tek të gjitha lëshesat pllakore/urat në menyrë që të mos ketë deformime/ulje të asfaltit për shkak të ndryshimit të shtangësise mbushje/beton. Kjo shërben për siguri të qarkullimit komod të trafikut dhe duhet të punohet për të gjitha rastet e paraqitura në këtë rregullore. Për sqarime të hollësishme projektuesi të konsultohet me “Standardet e rrugëve për punët ndërtimore për rrugë & ura Kosova e administruar nga KB: 2004”.

7. Trotuari dhe parmaket metalik duhet të punohen sipas “Standardet e rrugëve për punët ndërtimore për rrugë & ura Kosova e administruar nga KB: 2004”. Gjerësia minimale e trotuarit për këmbesorë të jetë jo më e vogël se $\geq 1.0\text{m}$ ndërsa parmaku metalik në lartësi 1.10m të punohet në trajete ballore me të urës me gjerësi $20\sim 25\text{cm}$. Në rast që rruga e projektuar ka shpejtësi më të madhe se $> 50\text{ km/h}$ guri skajor të vendosë në lartësi 7cm dhe të parashihet barriera/pahia metalike duke respektuar gjerësinë e lirë minimale të trotuarit prej 1m në të kundërtën skajori të vendoset në lartësinë 18cm si në skicë. Verejtje trotuari realizohet vetëm për rastin kur profili qarkullues i rrugës është $\geq 5.50\text{m}$.




Fig.9 Detaj i trotuarit dhe parmakut metalik.

8. Tek urat ku mbistruktura është me konstruksion të çelikut të mbeshetur në shtylla bregore nga BA, duhet të realizohet fuga dilatuese në mes të shtyllës bregore dhe soletës BA kompozit të mbistrukturës. Poashtu në shtyllat bregore duhet të punohen jastekët BA për fiksion të mbeshetësve metalik apo atyre elastik nga neopreni. Numri i trajeve metalike primare dhe sekondare përcaktohet nga kërkesa e kapaciteti i urës. Lamarina metalike e gungëzuar duhet të jetë rezistente ndaj korrezionit. Ajo duhet të fiksohet-saldohet në trajtë sekondare përmes ankerave të posaçëm (shear connectors) të parapara për pllaka kompozite sipas EC4 (EN 1994-1-1).




Fig.10 Detaj i mbistrukturës metalike me solete kompozite për urat $\geq 4.50m'$




Fig.11 Detaj i fugës dilatuese dhe mbetetsave prej elastomeri tek urat metalike $\geq 4.50\text{m}$

9. Gjatë hartimit të projektit duhet të ofrohen edhe projekti i sigurimit të gropës ndërtimore me palankola metalike apo hu-dërrase të cilat ngulen në afërsi të buzores së kanalit me anë të makinerisë hidraulike me vibrim. Projekti duhet të pregaditet nga personeli kompetent i fushës dhe

duhet te garantojnë me shkrim (deklaratë) për stabilitet të trupit të kanalit gjatë gjithë kohës së punimeve të shtyllave bregore. Pas punimit të shtyllave bregore dhe realizimit të mbushjeve përreth tyre, këto struktura sigurie të perkohshme duhet të demontohen dhe largohen nga vendpunishtja.







Fig.12 Detaj i palankolave metalike.




Emri i Projektit Project Name		RREGULLORE PËR NDERTIMIN E URAVE TË REJA MBI KANALET E NDERMARJES HE IL	
Niveli i Projektit Project Level	Projekti ideor	Faza e Projektit Project Phase	DISPOZITA
Përmbajtja e Faqes Page Content	PRERJA GJATESORE DHE P.TERTHORE E URES/LESHESES PROFILI 1.0+5.50+1.0 ME KRAH TE HAPUR		
Orientimi Orientation		Data Date	Prill, 2026
Përpjesa Scale	Sc: 1:50	Nr. i Faqes Page Nr.	DI-01

PLANIMETRIA_E_THEMELVE





Emri i Projektit Project Name		RREGULLORE PËR NDERTIMIN E URAVE TË REJA MBI KANALET E NDERMARJES HE IL	
Niveli i Projektit Project Level	Projekt i ideor	Faza e Projektit Project Phase	DISPOZITA
Përmbajtja e Faqes Page Content		PLANIMETRIA E THEMELEVE TE URES/LESHESSES PROFILI 1.0+5.50+1.0 ME KRAH TE HAPUR	
Orientimi Orientation		Data Date	Prill, 2026
Përpjesa Scale	Sc: 1:100	Nr. i Faqes Page Nr.	DI-02

FASADA_E_PESTE




Emri i Projektit Project Name		RREGULLORE PËR NDERTIMIN E URAVE TË REJA MBI KANALET E NDERMARJES HE IL	
Niveli i Projektit Project Level	Faza e Projektit Project Phase	Projekti ideor	DISPOZITA
Përmbajtja e Faqes Page Content		FASADA E PESTE E URES/LESHESSES PROFILI 1.0+5.50+1.0 ME KRAH TE HAPUR	
Orientimi Orientation	Data Date		Prill, 2026
Përpjesa Scale	Nr. i Faqes Page Nr.	Sc: 1:100	DI-03




Emri i Projektit Project Name		RREGULLORE PËR NDERTIMIN E URAVE TË REJA MBI KANALET E NDERMARJES HE IL	
Niveli i Projektit Project Level	Faza e Projektit Project Phase	Projekt i ideor	DISPOZITA
Përmbajtja e Faqes Page Content		PRERJA GJATESORE DHE P.TERTHORE E URES/LESHESES PROFILI 1.0+5.50+1.0 ME KRAH 90°	
Orientimi Orientation	Data Date		Prill, 2026
Përpjesa Scale	Nr. i Faqes Page Nr.	Sc: 1:50	D2-01

FASADA_E_PESTE




Emri i Projektit Project Name		RREGULLORE PËR NDERTIMIN E URAVE TË REJA MBI KANALET E NDERMARJES HE IL	
Niveli i Projektit Project Level	Faza e Projektit Project Phase	Projekti ideor	DISPOZITA
Përmbajtja e Faqes Page Content		FASADA E PESTE E URES/LESHESËS PROFILI 1.0+5.50+1.0 ME KRAH 90°	
Orientimi Orientation	Data Date		Prill, 2026
Përpjesa Scale	Nr. i Faqes Page Nr.	Sc: 1:100	D2-03

FASADA_E_PESTE



Emri i Projektit Project Name		RREGULLORE PËR NDERTIMIN E URAVE TË REJA MBI KANALET E NDERMARJES HE IL	
Niveli i Projektit Project Level	Faza e Projektit Project Phase	Projekti ideor	DISPOZITA
Përmbajtja e Faqes Page Content		FASADA E PESTE E URES/LESHESËS PROFILI 1.0+5.50+1.0 ME KRAH 90°	
Orientimi Orientation	Data Date		Prill, 2026
Përpjesa Scale	Nr. i Faqes Page Nr.	Sc: 1:100	D2-03

PLANIMETRIA E THEMELVE



Emri i Projektit
Project Name

RREGULLORE PËR NDERTIMIN E URAVE TË
REJA MBI KANALET E NDERMARJES HE IL

Niveli i Projektit
Project Level
Projekti ideor

Faza e Projektit
Project Phase
DISPOZITA

Përmbajtja e Faqes
Page Content

PLANIMETRIA E THEMELEVE
TE URES/LESHESSES
PROFILI ≥ 4.50m ME KRAH TE HAPUR


Orientimi
Orientation

Data
Date
Prill, 2026

Për pjesa
Scale
Sc: 1:100



Nr. i Faqes
Page Nr.
D3-02

FASADA_E_PESTE




Emri i Projektit Project Name		RREGULLORE PËR NDERTIMIN E URAVE TË REJA MBI KANALET E NDERMARJES HE IL	
Niveli i Projektit Project Level	Faza e Projektit Project Phase	Projekt i ideor	
Përmbajtja e Faqes Page Content		FASADA E PESTE E URES/LESHES PROFILI ≥ 4.50m ME KRAH TE HAPUR	
Orientimi Orientation	Data Date	Prill, 2026	
Përpjesa Scale	Nr. i Faqes Page Nr.	Sc: 1:100	
		D3-03	

- PARMAK METALIK PER URA
- ASFALT BETON 0-16 mm, t=4cm
- TAMPON PREJ GURI TE THYER CËLQEROR 0-31.5 mm, t=10cm
- PLLAKA E TRANZICIONIT NGA B.A C-30/37 t=25cm
- BETON I VARFËR C12/15 t=10cm
- MBUSHJE ME CBR>5%, NE SHITESA




Emri i Projektit Project Name		RREGULLORE PËR NDERTIMIN E URAVE TË REJA MBI KANALET E NDERMARJES HE IL	
Niveli i Projektit Project Level	Projekt i ideor	Faza e Projektit Project Phase	DISPOZITA
Përmbajtja e Faqes Page Content		PRERJA GJATESORE DHE P.TERTHORE E URES/LESHESES PROFILI ≥ 4.50m ME KRAH 90°	
Orientimi Orientation		Data Date	Prill, 2026
Për pjesa Scale	Sc: 1:50	Nr. i Faqes Page Nr.	D4-01

PLANIMETRIA_E_THEMELVE




Emri i Projektit Project Name		RREGULLORE PËR NDERTIMIN E URAVE TË REJA MBI KANALET E NDERMARJES HE IL	
Niveli i Projektit Project Level	Projekti ideor	Faza e Projektit Project Phase	DISPOZITA
Përmbajtja e Faqes Page Content	PLANIMETRIA E THEMELEVE TE URES/LESHESHE PROFILI $\geq 4.50m$ ME KRAH 90°		
Orientimi Orientation	Data Date Prill, 2026		
Përpjesa Scale	Nr. i Faqes Page Nr. D4-02		
Sc: 1:100			

FASADA_E_PESTE






Emri i Projektit Project Name		RREGULLORE PËR NDERTIMIN E URAVE TË REJA MBI KANALET E NDERMARJES HE IL	
Niveli i Projektit Project Level	Faza e Projektit Project Phase	Projekt i ideor	
Përmbajtja e Faqes Page Content		FASADA E PESTE E URES/LESHESSES PROFILI ≥ 4.50m ME KRAH 90°	
Orientimi Orientation	Data Date	Prill, 2026	
Për pjesa Scale	Nr. i Faqes Page Nr.	Sc: 1:100	
		D4-03	

PLANIMETRIA E THEMELVE




Emri i Projektit Project Name		RREGULLORE PËR NDERTIMIN E URAVE TË REJA MBI KANALET E NDERMARJES HE IL	
Niveli i Projektit Project Level	Faza e Projektit Project Phase	Projekt i ideor	DISPOZITA
Përmbajtja e Faqes Page Content	PLANIMETRIA E THEMELEVE TE URES/LESHES ME MBISTRUKTURE KOMPOZITE PROFILI ≥ 4.50m ME KRAH 90°		
Orientimi Orientation	Data Date	Prill, 2026	
Përpjesa Scale	Nr. i Faqes Page Nr.	Sc: 1:100	
		D5-02	

PLANIMETRIA E MAJTESVE TE MBISTRUKTURES



Emri i Projektit Project Name		RREGULLORE PËR NDERTIMIN E URAVE TË REJA MBI KANALET E NDERMARJES HE IL	
Niveli i Projektit Project Level	Projekt i ideor	Faza e Projektit Project Phase	DISPOZITA
Përmbajtja e Fildes Page Content	PLANIMETRIA E MBAJTESVE DHE DETAJE TE KONSTRUKSIONIT TE MBISTRUKTURE KOMPозITE TE URES/LESHESES TE PROFILI ≥ 4.50m ME KRAH 90°		
Orientimi Orientation		Data Date	Prill, 2026
Përpjesa Scale	Sc: 1:100	Nr. i Faqes Page Nr.	D5-03

FASADA_E_PESTE



Emri i Projektit Project Name		RREGULLORE PËR NDERTIMIN E URAVE TË REJA MBI KANALET E NDERMARJES HE IL	
Niveli i Projektit Project Level	Projekti ideor	Faza e Projektit Project Phase	DISPOZITA
Përmbajtja e Faqes Page Content		FASADA E PESTE ME MBISTRUKTURE KOMPOZITE TE URES/LESHESËS PROFILI ≥ 4.50m ME KRAH 90°	
Orientimi Orientation		Data Date	Prill, 2026
Për pjesa Scale	Sc: 1:100	Nr. i Faqes Page Nr.	D5-04